INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411


INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Tetor 2026

Norma e inflacionit e matur me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin Tetor 2026 ishte 3,4 për qind, nga 2,3 për qind në Tetor 2025.

Krahasuar me muajin Shtator 2026, çmimet e konsumit u rritën me 0,5 për qind.

FIG. 1 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Tetor është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +1,36 pikë përqindje, pasuar nga grupi "Transporti" me +0,73 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" ndikuan me +0,56 pikë përqindje, çmimet e grupit "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me +0,17 pikë përqindje, çmimet e grupit "Argëtim, sport dhe kulturë" me +0,15 pikë përqindje, çmimet e grupit "Pije alkoolike dhe duhan" me +0,14 pikë përqindje, çmimet e grupit "Restorante dhe shërbime akomodimi" me +0,11 pikë përqindje, çmimet e grupit "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me +0,10 pikë përqindje, çmimet e grupit "Sigurime dhe shërbime financiare" me +0,07 pikë përqindje, çmimet e grupit "Shëndeti" me +0,06 pikë përqindje dhe çmimet e grupit "Shërbimi arsimor" me +0,05 pikë përqindje. Nga ana tjetër çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" ndikuan me -0,10 pikë përqindje dhe çmimet e grupit "Informacioni dhe komunikimi" me -0,04 pikë përqindje.

Për publikim 09/11/2026

FIG. 2 NDIKIMI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Tetor 2025, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Transporti" me 11,4 %, pasuar nga "Argëtim, sport dhe kulturë" me 7,4 %, "Sigurime dhe shërbime financiare" me 4,4 %, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 4,0 %, "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me 2,8 %, "Pije alkoolike dhe duhan" me 2,7 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 2,4 %, "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me 2,3 %, "Restorante dhe shërbime akomodimi" me 2,0 %, etj. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" u ulën me 2,6 %, pasuar nga grupi "Informacioni dhe komunikimi" me 1,1 %.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me Shtator 2026, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Veshje dhe këpucë" me 1,5 %, pasuar nga grupet "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 1,2 %, "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme"me 0,7 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0,5 %, "Pije alkoolike dhe duhan" me 0,2 %, "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera", "Shëndeti" dhe "Argëtim, sport dhe kulturë" me 0,1 % secili. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Transporti" u ulën me 1,4 %, pasuar nga grupi "Restorante dhe shërbime akomodimi" me 0,1 %.

TAB. 1 INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Kodi	Grupet	Peshat	10-26/Viti 2025	10-26/09-26	10-26/10-25
	Gjithsej	**100,0**	**103,9**	**0,5**	**3,4**
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	34,1	103,7	1,2	4,0
02.	Pije alkoolike dhe duhan	5,0	103,2	0,2	2,7
03.	Veshje dhe këpucë	3,8	98,7	1,5	-2,6
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	20,2	104,6	0,1	2,8
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,0	103,2	0,5	2,4
06.	Shëndeti	3,2	101,9	0,1	1,7
07.	Transporti	6,4	111,4	-1,4	11,4
08.	Informacioni dhe komunikimi	3,6	99,1	0,0	-1,1
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	2,0	108,2	0,1	7,4
10.	Shërbimi arsimor	3,0	102,9	0,0	1,6
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	5,7	102,9	-0,1	2,0
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	1,5	104,4	0,0	4,4
13	Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme	4,5	103,1	0,7	2,3

Shënim për përdoruesit:

- *Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: Indeksi i Çmimeve të Konsumit*
- *Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf*

Metodologjia

Me publikimin e të dhënave për muajin Korrik 2026, është vënë në dispozicion seria kohore për periudhën 2016–2025 e Indeksit të Çmimeve të Konsumit, sipas ECOICOP 2018 (ECOICOP ver. 2). Gjatë përgatitjes së serisë kohore, disa produkte janë riklasifikuar në nivelet e detajuara. Indeksi i përgjithshëm i IÇK-së për çdo muaj mbetet i njëjtë deri në shifrën e dytë dhjetore. Për rrjedhojë, normat historike të inflacionit të përgjithshëm mbeten të pandryshuara.

Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga muaji Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përllogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.
Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.
Gjithashtu, në muajin janar si çdo vit Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar, duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2024.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga ***411*** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

Indekset e Çmimeve të Konsumit janë në proces rishikimi metodologjik për shkak të zbatimit të Klasifikimit ECOICOP ver. 2.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.
Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve ndërmjet muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.
Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm ndaj efekteve sezonale.
Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.